



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6120 /2024
Data: 19 .07. 2024

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 26.06.2024 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Prezent ishte nënkryetari i Komunës z. Sevdin Derrani. Takimin e kryesoj antari më i vjetër i Komitetit për Komunitete z. Zaim Bela

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me nënkryetarin e Komunës .
3. Takim me përfaqesuesit e HENDIKOS
4. Eventuale

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Zaim Bela (antari më i vjetër) thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me nënkryetarin e Komunës

Zaim Bela (antari me i vjeter) thekson:- Kisha pyetje për nënkryetarin lidhur me projektet e fundit ,për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Sevdi Dernjani thekson: Sa i perket punëve të fundit të komunës gjat muajit korrik gusht pasi që të kalohen në kuvend disa rialokime të buxhetit me u realizu projekti siq është rruga te Currt ,rruga te blaca 99 edhe është një zgjerim i rrugës në paldenic tek qeshma e kroit , gjithashtu edhe te rruga Adem jashari do të filloj pasi të nënshkruhet kontrata , sa i perket bifurkacionit vazhdimisht na njoftojnë për keqperdorim të ujit dhe demtimit të rrjetit të ujsjellsit , jemi duke menduar një projekt komplet të ri të ujesjellsit para disa ditesh kam vizitu fabriken e ujit kam pa që fabrika prodhon ujë dhe është në gjendje stabile po kur uji vjen posht në qytet ankohen qe nuk ka ujë realisht fabrika është gjithmonë në përpunim të ujit dhe ka ujë të mjaftueshem , një projekt tjetër është tek lagjja kollomoqe është një parcele private qe me marreveshje e kan ndertu shtëpin e pritjes po me shfrytzu një parcele të një qytetari që e ka dhëne në shfrytzim deri sa behet një zgjidhje perfundimtare kam biseduar me infrakosin ata e kan dhuru nje konstruksion metalik për me ndërto uren e hekurit për me kalu deri te shtëpia e pritjes jemi duke prit me marr konstruksionin metalik dhe në bashkëpunim me banoret e asaj zones me improvizu një ure për me kalu

Zaim Bela thekson: Rrugët janë demtuar te laqt ,a do të ketë mbikalime

Sevdi Dernjani thekson: Dy mbikalime kan me egzistu siq jane nje te fabrika e stiropolit dhe te uji i thart , jemi bazu në fjalët e zëvendes ministrit , sa i perket rruges tek laqt ka demtime të rrugeve nga punimet po na kemi me dergu një shkres për komplet demtimet që me i riparu

Hanumshahe Dibrani: A keni pa dike që keqperdor ujin dhe a është i pijshem

Sevdi Dernjani thekson: nuk jam kompetent për këte pjesë është bifurkacioni dhe instituti shendetit

Resul Suma thkeson: Uji nga fabrika është i pijshem por kur kalon në rrjet të ujesjellsit bëhet i pa pijshem

Ajnure Thaqi : A janë nderruar gypat e rrjetit të ujsjellsit

Sevdi Dernjani : Nuk janë nderruar komplet është pergjegjesi e bifurkacionit

Resul Suma : Lagjeja ku rri un ka uj ndersa në lagjen ka shkolla e mesme dardania ankohen qe nuk kan ujë

Sevdi Dernjani: Jane dy gypa të furnizimit me uje një është ka shkolla e tjetra ka qyteti e ai gypi qe shkon ka shkolla ka ngecje nuk e di arsyjen realisht është desht prej një gypit me u shpernda tek rrjeti ujesjellsit edhe me kolektor kolektiv me u bë matja e ujit me u pa se sa keqperdoret në lagjet

Zaim Bela thekson: Fabrika nuk prodhon ujë po vetem e filtron , ka uj të bollshem në fabrik është mire të mirret një ekspert dhe të behet zgjidhja perfundimtare e ujit 171 në sekond është shume uj që me pas ankesa që nuk ka uje por nuk e di ku është problemi a keqperdoret apo qka duhet të shkeputen lidhjen ilegale

Resul Suma thekson: Gropat qe janë bë në rrugë duhet rregulluar

Sevdi Dernjani thekson: Puna e bifurkacionit është pune e paknaqshme sepse hapen gropat për ujesjellsin dhe nuk rregullohet si duhet.

Hanumshahe Dibrani thekson: Fabrika e kromit në Goranc a është mbyll

Sevdi Dernjani thekson: Eshtë kompani private nuk kam informacione të sakta por e di që nuk kanë një lincens

3. Takim me përfaqësuesit e HENDIKOS


Zaim Bela (antari më i vjetër) thekson : Kalojmë në pikën tjetër të rendit të punës për shkak që nuk janë prezent

4. Eventuale

Antaret e Komitetit për komunitet diskutuan rreth keqperdorimit të ujit

Mbledhja përfundoi në 14:40

Procesmbajtësja
Sara Berisha ,



Anëtari më i Vjetër
Zaim Bela



